

# Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "M.E.A.Saranda\_Alba" sh.p.k  
Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.B. dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tyre te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortakët : Fatmir Islam Çeka, Achille Antonio Canzano dhe Ettore Mario Esposito , krijojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "M.E.A. Saranda Alba" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

## Formulimi

### Neni 1

Krijohet shoqeria tregtare private e quajtur "M.E.A. Saranda Alba" sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues .

## Selia e Shoqerise

### Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private "M.E.A. Saranda Alba" sh.p.k do te kete seline ne Lagja 1, Rruga "Butrinti", godine 3-kate, Nr.218, Sarande.  
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese te ortakeve .

## Objektivi I Veprimtarise


### Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e :  
"Hoteleri – Turizmit, Bar-Restorant, Import- Eksport artikuj te ndryshem ushqimor dhe industrial, pije te ndryshme, mjete dhe paisje".

## Kohezgjatja e Shoqerise

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut .



## Kapitali I Shoqerise

### Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "M.E.A. Saranda Alba" sh.p.k do te jete 100.000 (njeqindmije leke ).

Kapitali eshte i ndare ne 3(tri) kuota te ndara keto ne:

Fatmir Islam Çeka , 1(nje) kuote, 33333 (Tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre) leke ose 33.333% te aksioneve

Achille Antonio Canzano, 1(nje) kuote 33333 (Tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre) leke ose 33.333% te aksioneve

Ettore Mario Esposito , 1(nje) kuote 33333 (Tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre) leke ose 33.333% te aksioneve

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar ).

## Drejtimi I Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga , z. Fatmir Islam Çeka , ne cilesine e Administratorit te Shoqerise.. Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

### Neni 7

Administratori ka te drejte te emeruje dhe administratore te tjere te vlerave materiale

Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortakë .

### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

### Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

### Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

### Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 4 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "M.E.A. Saranda Alba" sh.p.k

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqerise .

Ky akt-themelimi hartohet dhe nenshkruhet sot me dt. 17.05.2021

**Ortaket themelues te Shoqerise " M.E.A. Saranda Alba " sh.p.k**

(Fatmir Islam Çeka )



(Achille Antonio Canzano )



(Ettore Mario Esposito )

